

20231542755

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE(*)

Neni 1

Në Ligjin e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168 /18, 248/18 dhe 27/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 42/20 dhe 77/21) neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Me këtë ligj rregullohen të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë në sferën e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale, duke përfshirë edhe radiodifuzerët dhe ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë; ofruesit e shërbimeve të platformave për shpërndarjen e videove dhe operatorët e rrjeteve publike elektronike të komunikimit të cilat i emetojnë ose rriemetojnë serviset programore të radiodifuzerëve.”.

Neni 2

Në nenin 3, pikat 1, 2 dhe 5 ndryshohen si më poshtë:

„1. Shërbimi mediatik audio dhe audiovizual është:

a) shërbimi nën përgjegjësinë redaktuese të ofruesit të shërbimit mediatik nga ku qëllimi bazë i shërbimit ose pjesës së tij të veçantë i kushtohet ofrimit të programeve të destinuara për publikun e gjerë me qëllim që të informohet, argëtohet ose edukohet, nëpërmjet rrjeteve elektronike komunikuese në kuptim të përkufizimeve të ligjit me të cilin rregullohen komunikimet elektronike, nga ku shërbimi i tillë mund të jetë shërbim mediatik linear audio ose audiovizual (radio ose program televiziv), shërbim mediatik audiovizual me kërkesë, ose

b) Komunikime komerciale audio dhe audiovizuale.

Për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nuk konsiderohen:

a) shërbimet që para së gjithash, janë jofitimprurëse dhe që nuk janë në konkurrencë me emetim të radios apo të televizionit, siç janë webfaqet private

b) shërbimi i transmetimit, përkatësisht shpërndarjes së programeve për të cilat përgjegjësinë redaktuese e kanë persona të tretë,

v) çfarëdo forme e komunikimit privat, siç është posta elektronike e dërguar te një numër i kufizuar i pranuesve dhe

g) shërbime, qëllimi primar i të cilave nuk është sigurimi i programeve, ku çdo përmbajtje audiovizuale është vetëm e rastësishme për shërbimin dhe nuk është qëllimi i saj primar siç janë:

- faqe të internetit që përmbajnë elemente audiovizuale vetëm në mënyrë ndihmëse, siç janë elemente grafike të animuara, videoklipe të shkurtra reklamuese ose informacione të lidhura me ndonjë prodhim ose shërbim i cili nuk është audiovizual,

- lojërat e fatit që përfshijnë depozitë me para, duke përfshirë edhe lotaritë, bastin dhe forma tjera të shërbimeve për bixhoz,

- lojëra onlajn,

- kërkues,

- versione elektronike të gazetave dhe magazinave dhe

- shërbime të pavarura të bazuara tekstuale”.

2. Program audiovizual është tërësia nga fotografitë lëvizëse me ose pa zë, pavarësisht nga kohëzgjatja që paraqet element të veçantë në kuadër të radhitjes kronologjike të programeve (skemë programore) ose nga katalogu me programe të përcaktuar nga ofruesi i shërbimeve

* Ky ligj është në përputhje me Direktivën (BE) 2018/2018 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 14 nëntor 2018, që ndryshon Direktivën 2010/13/BE për koordinimin e disa dispozitave të përcaktuara me ligj, rregullore ose akte administrative në vendet anëtare për ofrimin e shërbimeve mediatike audiovizuale (numri CELEX 32018L1808).

mediatike, të cilat përfaqësojnë tërësi të projektuara me funksion argëtues, edukues ose me funksion informativ, siç janë filmat artistik me metrazh të gjatë, videoklipe, ngjarjet sportive, komedi të situatës, emisionet dokumentare, programet për fëmijë, dramat televizive etj;”.

5. Komunikime komerciale audiovizuale janë fotografi me apo pa zë që janë krijuar:

- për promovimin direkt ose indirekt të prodhimeve, shërbimeve ose imazhit të personave fizikë ose juridikë që kryejnë aktivitet ekonomik ose

- për popullarizimin e ndonjë ideje, aktiviteti ose për arritjen e ndonjë efekti tjetër.

Komunikimet komerciale audiovizuale i bashkangjiten ose janë përfshirë në programin ose në videon e krijuar nga përdorues për kompensim me para ose për kompensim tjetër për qëllime vetëpromovuese të porositësit. Forma të komunikimeve audiovizuale komerciale mes tjerash janë reklamimi televiziv, teleshoppingu, sponsorizimi dhe vendosja e prodhimeve.

Pas pikës 5 shtohet pikë e re 5-a, si më poshtë

„5-a. Komunikimi audio komercial është përmbajtje që është krijuar për:

- për promovimin direkt ose indirekt të prodhimeve, shërbimeve ose imazhit të personave fizikë ose juridikë që kryejnë aktivitet ekonomik ose

- për popullarizimin e ndonjë ideje ose aktiviteti ose për arritjen e ndonjë efekti tjetër.

Komunikimet audio komerciale i bashkangjiten ose janë përfshirë në programin për kompensim me para ose për kompensim tjetër për qëllime vetëpromovuese të porositësit. Forma të komunikimeve audiovizuale komerciale mes tjerash janë reklama radioje, sponsorizimi dhe vendosja e prodhimeve.

Pikat 15 dhe 20 ndryshohen si më poshtë:

“15. Vendosje e prodhimit është çdo formë e komunikimit komercial audio dhe audiovizual që përbëhet nga përfshirja ose sugjerimi i prodhimit, shërbimit ose shenjë mbrojtëse në ndonjë program, ose video të krijuar nga përdorues kështu që ato janë të përfshira në veprimtarinë e tij, për kompensim me para ose lloj tjetër;”.

20. Sponsorizim është secili kontribut nga personi juridik ose fizik i cili nuk është përfshirë në sigurimin e shërbimeve audio dhe audiovizuale mediatike ose shërbimit të platformës për shpërndarjen e videove ose në produksionin e veprave audio dhe audiovizuale, për shkak të financimit të shërbimeve audio dhe audiovizuale mediatike, shërbimit të platformës për shpërndarjen e videove, video të krijuar nga përdorues, ose programe, me qëllim që ta promovojë emrin e vet, shenjën mbrojtëse, imazhin, aktivitetet ose prodhimet;“.

Pas pikës 26 shtohet pikë e re 26-a, si më poshtë

„26-a. Vendim redaktues është çdo vendim i cili merret në bazë të rregullt me qëllim për tu realizuar përgjegjësia redaktuese, lidhur me funksionimin e përditshëm të shërbimit mediatik audio dhe audiovizual;”.

Pas pikës 27 shtohen pesë pika të reja 28, 29, 30, 31 dhe 32, si më poshtë:

„28. Shërbimi platformë për shpërndarjen e videove është shërbim i shoqërisë informatike, i cili është i destinuar për publikun e gjerë dhe sigurohet nëpërmjet rrjetit elektronik komunikues, qëllimi kryesor dhe/ose funksionaliteti bazë në tërësi dhe/ose ose në pjesën e tij të veçantë, është t’i sigurojë publikut qasje në programet dhe/ose videot e krijuara nga përdorues, të cilat kanë funksion informues, edukues ose argëtues, për të cilat ofruesi i shërbimit nuk ka përgjegjësi redaktuese për përmbajtjen, por ai vetëm e përcakton mënyrën në të cilën shërbimi është i organizuar, duke përfshirë mjetet ose algoritmet automatike, në veçanti përmes shfaqjes, shënimit ose renditjes së përmbajtjes;

29. Video e krijuar nga përdorues është tërësia e fotografive lëvizëse me ose pa zë, pavarësisht nga kohëzgjatja që paraqet element të veçantë, e krijuar nga përdorues dhe ngarkuar në platformë për shpërndarjen e videove nga ai ose përdorues tjetër;

30. Ofrues i shërbimit platformë për shpërndarjen e videove është person fizik ose juridik që siguron shërbimin platformë për shpërndarjen e videove;

31. Vetërregullimi paraqet lloj të iniciativës vullnetare që u lejon operatorëve ekonomikë, partnerëve socialë, organizatave joqeveritare dhe shoqatave të miratojnë udhëzime të përbashkëta mes tyre dhe për vete, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin, monitorimin dhe zbatimin e harmonizimit me ato udhëzime dhe

32. Bashkërregullimi është sistem që në formën e tij minimale ofron lidhje ligjore ndërmjet vetërregullimit dhe rregullimit. Në bashkërregullim, roli rregullator ndahet ndërmjet palëve të interesuara dhe trupave rregullatore kompetente.”.

Neni 3

Në nenin 6, paragrafi (1), nënparagrafi 7 ndryshohet si më poshtë:

„- kujdeset për mbrojtjen e interesave të qytetarëve në sferën e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale, si dhe për vlerësimin e masave për mbrojtjen e interesave të tyre të zbatuar nga shërbimet e platformave për shpërndarjen e videove“.

Nënparagrafi 15 ndryshohet si më poshtë:

„- zbaton hulumtime dhe analiza lidhur me çështje të caktuara në sferën e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale dhe shërbimeve të platformës për shpërndarjen e videove,“.

Nënparagrafi 16 fshihet.

Paragrafi (2) fshihet.

Neni 4

Në nenin 15, në paragrafin (2), para fjalës “mandati” shtohen fjalët “të njëpasnjëshme ose jo të njëpasnjëshme”:

Neni 5

Në nenin 18, paragrafi 7 ndryshohet si më poshtë:

„- vendos për çështje që lidhen me identifikimin dhe regjistrimin e shërbimeve të platformave për shpërndarjen e videove dhe për kërkesat që ato duhet të përmbushin, siç janë publikimin e impresumit, detyrimet e tyre, masat për të siguruar respektimin e detyrimeve dhe çështjet që lidhen me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve,“.

Neni 6

Në nenin 23, në paragrafi (1), pas fjalës “kërkesë” vihet presje dhe shtohen fjalët “ofruesi i shërbimit të platformës së shkëmbimit të videove”.

Neni 7

Në nenin 26, paragrafi (1) ndryshohet si më poshtë:

“(1) Ofruesit e shërbimeve mediatike janë të detyruar të zbatojnë në vazhdimësi dhe në mënyrë përparuese masa të përshtatshme dhe proporcionale për shërbimet e tyre që të jenë më të pranueshme për personat me aftësi të kufizuara.”.

Pas paragrafit (1) shtohen 4 paragrafë të rinj (2), (3), (4), (5), si më poshtë:

(2) Për zbatimin e masave të paragrafit (1) të këtij neni, ofruesit e shërbimeve mediatike miratojnë plan aksional për vitin e ardhshëm dhe e dorëzojnë pranë Agjencisë deri më 31 dhjetor të vitit aktual.

(3) Ofruesit e shërbimeve mediatike dorëzojnë raport vjetor pranë Agjencisë për përmbushjen e planit aksional të paragrafit (2) të këtij neni, deri më 31 mars të vitit aktual, për vitin kalendarik pararendës.

(4) Agjencia themelon pikë kontakti online përmes së cilës ofron informacione dhe pranon ankesa në lidhje me qasjen e shërbimeve për personat me aftësi ndryshe.

(5) Ofruesit e shërbimeve mediatike janë të detyruar informacionet për situatat emergjente, duke përfshirë kumtesat dhe njoftimet publike në rast të fatkeqësive natyrore, të cilat janë në dispozicion të publikut përmes shërbimeve mediatike audiovizuale, që t'i ofrojnë në format të disponueshëm dhe të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara, i cili përfshin por nuk kufizohet në shpjegimin e teksteve të hapura dhe të mbyllura, gjuhës së shenjave, përshkrimin audio dhe të tjera.

Paragrafi (2) bëhet paragrafi (6).

Në paragrafët (3) dhe (4), të cilët bëhen paragrafët (7) dhe (8), numri (2) zëvendësohet me numrin (6).

Pas paragrafit (4) i cili bëhet paragrafi (8), paragraf i ri (9) shtohet, si më poshtë:

„(9) Masat e paragrafit (1) të këtij neni dhe mënyra e zbatimit të detyrimeve nga paragrafët (2), (3), (4) dhe (5) i përcakton Agjencia.“.

Neni 8

Pas nenit 26, shtohet titull i ri dhe nen i ri 26-a, si më poshtë:

“Neni 26-a

Bashkëregullimi dhe vetërregullimi

(1) Bashkëregullimi dhe vetërregullimi zbatohen përmes kodekseve të sjelljes me të cilat, në përputhje me dispozitat e këtij ligji rregullohen çështje të caktuara, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- reduktimin në mënyrë efektive të ekspozimit të personave të mitur në komunikimet komerciale në lidhje me pijet alkoolike dhe

- komunikimet komerciale në lidhje me ushqimet dhe pijet që përmbajnë materie ushqyese dhe përbërës ushqimorë me efekt ushqyes ose fiziologjik, veçanërisht yndyrnat, acidet transydyrore, kripë, natrium dhe sheqerna, marrja e tepërt e të cilave nuk rekomandohet në të ushqyerit e fëmijëve,

(2) Agjencia e inkurajon përdorimin e bashkëregullimit dhe vetërregullimit përmes kodekseve të sjelljes, të miratuara në nivel nacional, për çështje të caktuara që i mbulon ky ligj.

(3) Kodekset e paragrafit (1) të këtij neni duhet:

- të jenë të pranuarra gjerësisht nga palët kryesore të interesit,
- t'i përcaktojnë qëllimet e tyre në mënyrë të qartë dhe pa mëdyshje,
- të ofrojnë monitorim dhe vlerësim të rregullt, transparent dhe të pavarur të realizimit të qëllimeve të tyre dhe

- të përcaktojnë procedurat e respektimit të rregullave të vendosura dhe përgjegjësinë e palëve për shkeljet e rregullave, duke përfshirë masat efektive dhe proporcionale për mosrespektimin e tyre

(4) Sistemet vetërregulluese duhet të përdorin kodekse sjelljeje të përgatitura nga ofruesit e shërbimeve mediatike, ofruesit e shërbimeve të platformës së shpërndarjes së videove ose organizatat që përfaqësojnë, në bashkëpunim, nëse është e nevojshme, me sektorë të tjerë siç është industria, tregtia, shoqatat profesionale dhe organizata dhe organizatat e konsumatorëve, duke përfshirë edhe kodekset e sjelljes të përgatitura në bashkëpunim ndërkombëtar.”.

Neni 9

Neni 45 ndryshohet si më poshtë:

“(1) Me përjashtim të nenit 44 të këtij Ligji, Agjencia ndërmerr masa përkatëse me të cilat përkohësisht kufizon lirinë e pranimit, përkatësisht riemetimit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale nga vendet anëtare të Bashkimit Europian në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Agjencia i ndërmerr masat e paragrafit (1) të këtij neni kur ofruesi i shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale nën juridiksionin e vendeve anëtare të Bashkimit European shkel hapur seriozisht dhe rëndë dispozitat e neneve 48, paragrafi (2) dhe 50 të këtij ligji, ose vë në pikëpyetje shëndetin publik, ose paraqet rrezik serioz dhe të rëndë për të vënë në pikëpyetje shëndetin publik, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- gjatë periudhës së 12 muajve të mëparshëm, ofruesi i shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale, së paku dy herë, ka kryer një ose më shumë veprime që paraqesin shkelje të hapur, serioze dhe të rëndë të nga dispozitat e nenit 48, paragrafi (2) dhe 50 të këtij Ligji, ose vë në pikëpyetje shëndetin publik, ose paraqet rrezik serioz dhe të rëndë për të vënë në pikëpyetje shëndetin publik

- Agjencia me shkrim i ka njoftuar ofruesin e shërbimit mediatik audio dhe audiovizual, trupin rregullator të vendeve anëtare të Bashkimit European që ka juridiksion mbi punën e ofruesit dhe Komisionin European për shkeljet e supozuara dhe masat proporcionale që ka për synim t'i ndërmarrë nëse ndodh një shkelje e re e tillë;

- Trupi rregullator i vendeve anëtare të Bashkimit European që ka juridiksion mbi ofruesin respekton të drejtën e mbrojtjes së ofruesit të shërbimit mediatik audio dhe audiovizual dhe në veçanti, i mundëson ofruesit të paraqesë pikëpamjet e tij për shkeljet e pretenduara të dispozitave të nënparagrafit 1 të këtij paragrafi;

- konsultimet me vendet anëtare të Bashkimit European që ka juridiksion mbi ofruesin dhe me Komisionin European nuk kanë rezultuar me zgjidhje miqësore brenda një muaji pasi Komisioni European ka marrë njoftimin e theksuar në nënparagrafin 2 të këtij paragrafi; dhe

- Komisioni European ka vendosur që masat e propozuara janë në përputhje me rregulloret e Bashkimit European.

(3) Agjencia i ndërmerr masat e paragrafit (1) të këtij neni kur ofruesi i shërbimeve mediatike audio audiovizuale nën juridiksionin e një shteti anëtar të Bashkimit European, haptazi, rëndë dhe seriozisht shkel dispozitat e nenit 48, paragrafi (1) të këtij Ligji ose vë në pikëpyetje sigurinë publike ose paraqet rrezik serioz dhe të rëndë për të vënë në pikëpyetje sigurinë publike duke përfshirë dhe mbrojtjen e sigurisë dhe mbrojtjes nacionale, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- në 12 muajt e mëparshëm, ofruesi i shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale, të paktën një herë ka kryer një ose më shumë veprime që kanë shkelur hapur, rëndë dhe seriozisht dispozitat e nenit 48, paragrafi (1) të këtij ligji ose kanë vënë në pikëpyetje sigurinë publike, ose paraqet rrezik serioz dhe të rëndë për të vënë në pikëpyetje sigurinë publike, duke përfshirë edhe mbrojtjen e sigurisë dhe mbrojtjes nacionale;

- Agjencia ka njoftuar ofruesin e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale trupin rregullator të vendeve anëtare të Bashkimit European që ka juridiksion mbi punën e ofruesit dhe Komisionit European për shkeljet e supozuara dhe për masat proporcionale që synon të ndërmarrë nëse një shkelje e tillë ndodh përsëri;

- Trupi rregullator i vendeve anëtare të Bashkimit European që ka juridiksion mbi ofruesin respekton të drejtën e mbrojtjes së ofruesit të shërbimit mediatik audio dhe audiovizual dhe, në veçanti, i mundëson ofruesit të paraqesë pikëpamjet e tij për shkeljet e pretenduara; dhe

- Komisioni European ka vendosur që masat e propozuara janë në përputhje me rregulloret e Bashkimit European.

(4) Në raste urgjente, por jo më vonë se një muaj pas shkeljes së dispozitave të nenit 48 paragrafi (1) të këtij ligji, Agjencia mund të shmangë kushtet e paragrafit (3), nënparagrafët 1 dhe 2 të këtij neni, si dhe të informojë Komisionin European sa më shpejt që të jetë e mundur dhe organin rregullator të vendeve anëtare të Bashkimit European në juridiksionin e të cilit ofruesi i shërbimit mediatik është për masat që ka marrë, duke treguar arsyet pse e ka konsideruar si emergjencë.

(5) Agjencia menjëherë e ndërpretë zbatimin e masave për rastet sipas paragrafëve (2) dhe (3) të këtij neni, nëse Komisioni Europian vendos se masat nuk janë në përputhje me rregullat e Komisionit Europian.

(6) Dispozitat e këtij neni zbatohen në mënyrë adekuate me shërbimet që janë nën juridiksionin e vendeve nënshkruese të Konventës Europiane për Televizionin Ndërkufitar.”.

Neni 10

Pas nenit 45, shtohet titull i ri dhe nen i ri 45-a, si më poshtë:

“Neni 45-a

Rregulla më të hollësishme dhe më të rrepta

(1) Nëse ofruesi i shërbimeve mediatike audiovizuale nën juridiksionin e vendeve anëtare të Bashkimit Europian i shkel dispozitat e këtij ligji në të cilin përcaktohen rregulla më të hollësishme ose më të rrepta se sa rregullat e atij shteti, Agjencia mund t’i ndërmarrë masat e mëposhtme:

- të kërkojë nga ofruesi i shërbimit mediatik audiovizual nën juridiksionin e vendeve anëtar të Bashkimit Europian që t’i respektojë dispozitat e neneve 48, 50 dhe 53 të këtij ligji ose

- të kërkojë nga vendi anëtar i Bashkimit Europian nën juridiksionin e të cilit është ofruesi i shërbimit mediatik audiovizual që t’i heqë të gjitha parregullsitë e konstatuara në veprimtarinë e ofruesit, nëse konstaton se ai ofron shërbim mediatik audiovizual që në tërësi ose në një pjesë më të madhe e drejtuar kah territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Agjencia mund t’i ndërmarrë masat e paragrafit (1) të këtij neni nëse:

- vlerësojnë se rezultatet e marra nga shteti anëtar i Bashkimit Europian që ka juridiksion mbi ofruesin e shërbimit mediatik audiovizual nuk janë të kënaqshme dhe

- në mënyrë të arsyeshme mund të përcaktohet se ofruesi i shërbimeve mediatike është themeluar në vende anëtare të Bashkimit Europian që ka juridiksion mbi ofruesin e shërbimit mediatike audiovizuale me qëllim ë të anashkalojë rregullat më të rrepta që do të zbatoheshin për të nëse do të themelohej në Republikën e Maqedonia e Veriut.

(3) Masat e paragrafit (1) të këtij neni duhet të jenë objektivist të domosdoshme, të zbatuara në mënyrë jodiskriminuese dhe proporcionale me qëllimet që duhet të arrihen me masat.

(4) Agjencia mund t’i ndërmarrë masat e paragrafit (1) të këtij neni vetëm nëse plotësohen këto kushte:

- e njofton Komisionin Europian dhe vendeve anëtare të Bashkimit Europian në të cilin është themeluar ofruesi i shërbimit mediatik me synim që t’i ndërmarrë masat dhe për të mbështetur me prova arsyet mbi të cilat ata e bazojnë vlerësimin e tyre;

- e ka respektuar të drejtën e mbrojtjes të ofruesit të interesuar të shërbimit mediatik dhe ofruesit të shërbimit mediatik i dha mundësinë për të shprehur pikëpamjet e tij për anashkalimin e supozuar dhe masat që ka për qëllim t’i ndërmerr dhe

- Komisioni Europian ka vendosur që masat e paragrafit (1) të këtij neni janë në përputhje me ligjin e Bashkimit Europian, veçanërisht që aktivitetet e paragrafit (2) të këtij neni të ndërmarrë nga Republika e Maqedonisë së Veriut janë të bazuara siç duhet”.

(5) Dispozitat nga ky nen zbatohen në mënyrë adekuate për shërbimet që janë nën juridiksionin e vendeve nënshkruese të Konventës Europiane për Televizionin Ndërkufitar.”.

Neni 11

Neni 46 dhe titulli i neni 46 ndryshohen si më poshtë:

“Neni 46

Juridiksioni mbi shërbimet mediatike audiovizuale

(1) Dispozitat e këtij ligji zbatohen te të gjithë ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale që janë nën juridiksionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Nën juridiksion të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë ata ofrues të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale që janë themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni ose ata për të cilat zbatohet paragrafi (4) i këtij neni.

(3) Ofruesi i shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale konsiderohet se është themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nëse:

- selia e ofruesit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale gjendet në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe vendimet redaktuese në lidhje me shërbimet mediatike audio ose audiovizuale miratohen në Republikën e Maqedonisë së Veriut,

- selia e ofruesit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale gjendet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe pjesë e konsiderueshme e fuqisë punëtore e angazhuar në aktivitetet lidhur me shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale është në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa vendimet redaktuese lidhur me shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale miratohen në vendeve anëtare të Bashkimit Europian;

- selia e ofruesit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale gjendet në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe pjesë e konsiderueshme e fuqisë punëtore e angazhuar në aktivitetet lidhur me aspektet programore të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale është edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe vendeve tjera anëtare të Bashkimit Europian;

- pjesë e konsiderueshme e fuqisë punëtore e angazhuar në aktivitetet lidhur me aspektet programore të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale nuk gjendet as në Republikën e Maqedonisë së Veriut as në shtet-anëtar të Bashkimit Europian, por ofruesi i shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale fillimisht e filloi veprimtarinë e saj në Republikën e Maqedonisë së Veriut në përputhje me rregulloret e saj, me kusht që të mbajë marrëdhënie të qëndrueshme dhe efektive me ekonominë e Republikës së Maqedonisë së Veriut;

- selia e ofruesit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale gjendet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe pjesë e konsiderueshme e fuqisë punëtore e angazhuar në aktivitetet lidhur me shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale gjendet në Republikën e Maqedonisë ndërsa vendimet redaktuese lidhur me shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale miratohen në shtet i cili nuk është anëtar i Bashkimit Europian, ose anasjelltas.

(4) Ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale për të cilët nuk zbatohen dispozitat e paragrafit (3) të këtij neni konsiderohet se janë nën juridiksionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nëse:

- shfrytëzojnë lidhje satelitore të lokalizuar në Republikën e Maqedonisë dhe

- nuk shfrytëzojnë lidhje satelitore të lokalizuar në Republikën e Maqedonisë, por shfrytëzojnë kapacitete satelitore që i përkasin Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale nën juridiksionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të detyruar ta njoftojnë Agjencinë për të gjitha ndryshimet që mund të ndikojnë mbi përcaktimin nën juridiksionin e të cilit bëjnë pjesë.

(6) Agjencia udhëheq lista të përditësuara të ofruesve të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale nën juridiksionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me dispozitat e neneve 57 dhe 66 të këtij ligji dhe të njëjtat Agjencia i dorëzon pranë Komisionit Europian.”.

Neni 12

Pas nenit 47, shtohet titulli i ri dhe neni i ri 47-a si më poshtë:

“Neni 47-a

Parime

Ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre duhet t'i respektojnë parimet e mëposhtme:

- kultivimin dhe zhvillimin e vlerave humane dhe morale të njeriut dhe mbrojtjen e privatësisë dhe dinjitetit të personalitetit,
- barazinë e lirive dhe të drejtave pavarësisht nga gjinia, raca, prejardhja nacionale, etnike dhe sociale, bindja politike dhe fetare, gjendja pronësore dhe shoqërore e njeriut dhe qytetarit,
- nxitjen e frymës së tolerancës, respektimit të ndërsjellë dhe mirëkuptimit ndërmjet individëve me prejardhje të ndryshme etnike dhe kulturore,
- mbrojtjen e identitetit të viktimave të dhunës,
- respektimin e prezumimit të pafajësisë,
- nxitjen e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, ndjenjën e publikut për drejtësi dhe për mbrojtje të lirive demokratike,
- transparencën e programeve për shprehjen e kulturave të ndryshme që janë pjesë përbërëse e shoqërisë,
- ruajtjen dhe kultivimin e identitetit nacional, kulturës gjuhësore dhe krijimtarisë vendore,
- paraqitjen e ngjarjeve në mënyrë objektive dhe të paanshme me trajtim të njëjtë të pikëpamjeve dhe mendimeve të ndryshme dhe mundësimin e formimit të lirë të mendimit të publikut për ngjarje të caktuara dhe çështje,
- respektimin e të drejtës autoriale dhe të drejtave të përafërta,
- respektimin e fshehtësisë së burimit të informatës,
- garantimin e të drejtës së përgjigjes dhe korrigjimit dhe
- mëvetësinë, pavarësinë dhe përgjegjësinë e redaktorëve, gazetarëve dhe autorëve tjerë gjatë krijimit të programeve dhe krijimit të politikës redaktuese.”

Neni 13

Neni 48 ndryshohet si më poshtë:

“(1) Shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale nuk guxojnë të përmbajnë programe, videoklipe ose komunikime audiovizuale komerciale me të cilat rrezikohet siguria nacionale, nxitet rrënimi i dhunshëm i rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut, thirret në agresion ushtarak ose në konflikt të armatosur ose përmbajtje, shpërndarja e të cilave paraqet aktivitet të paligjshëm, duke përfshirë edhe nxitjen publike për kryerje të akteve terroriste, akteve që lidhen me pornografinë e fëmijëve dhe akteve që lidhen me racizmin dhe ksenofobinë.

(2) Shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale nuk guxojnë të përmbajnë programe, videoklipe ose komunikime komerciale audiovizuale që nxisin ose përhapin diskriminim, mosdurim, dhunë ose urrejtje në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes nacionale ose etnike, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, përkatësisë në grup të marginalizuar, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale, religjionit ose besimit fetar, besimit politik, besimit tjetër, paaftësia, moshë, statusi familjar ose martesor, gjendja pronësore, gjendja shëndetësore, karakteristika personale dhe statusi social ose ndonjë bazë tjetër.

(3) Ndalimet e veçanta sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni janë në përputhje me praktikën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.”

Neni 14

Pas nenit 49 shtohet titull i ri dhe neni i ri 49-a si më poshtë:

“Neni 49-a

Integriteti i sinjalit të shërbimeve mediatike audiovizuale

(1) Shërbimet mediatike audiovizuale që i sigurojnë ofruesit e shërbimeve të tilla nuk mund të mbulohen me sinjal tjetër ose të modifikohen për qëllime komerciale pa pëlqimin e shprehur të ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, pa pëlqimin paraprak të ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale, lejohen veprimtaritë për:

- mbulim me sinjal tjetër që e inicoi ose aprovoi përdoruesi i shërbimit për përdorim në qëllime private;
- shfaqja e elementeve të kontrollit të përdoruesit të ndërfaqes së nevojshme për menaxhimin e pajisjes ose për të kontrolluar në listën e programeve, shfaqja e fuqisë së zërit, funksionet e kërkimit, menyte e rregullimit ose listat e kanaleve;
- paralajmërime dhe njoftime;
- informacione me interes të përgjithshëm publik;
- titra dhe
- komunikime komerciale që i ofrojnë ofruesit e shërbimeve mediatike.”.

Neni 15

Neni 50 ndryshohet si më poshtë:

(1) Radiodifuzerët nuk guxojnë të emetojnë ose transmetojnë programe që mund seriozisht ta dëmtojnë zhvillimin fizik, psikik ose moral të personave të mitur, veçanërisht programe që përmbajnë pornografi ose dhunë të panevojshme. Ofruesit e shërbimeve sipas kërkesës duhet të ndërmarrin masa më të rrepta teknike për të siguruar që personat e mitur janë të mbrojtur nga përmbajtje të dëmshme siç janë dhuna e panevojshme dhe pornografia

(2) Dhuna e panevojshme paraqet përhapja e porosive tekstuale, verbale ose vizuale me të cilat në orare të programit që janë të kapshme për personat e mitur, lartësohen forma fizike, verbale ose psikologjike të sadizmit ose forma të ngjashme të dhunës që është qëllim në vete dhe në asnjë mënyrë nuk mund të arsyetohet as nëpërmjet kontekstit të zhanrit, as nëpërmjet motiveve të veprimit dramatik të programit të transmetuar.

(3) Përveç programeve të paragrafit (1) të këtij neni, programe të tjera që do të mund ta ta dëmtonin zhvillimin fizik, psikik ose moral të personave të mitur, ofrohen nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale në mënyrë që personat e mitur që të mos mund të shohin ose dëgjojnë programet në mënyrën e zakonshme. Kur programet emetohen ose përsëriten në formë të pakoduar, ofruesi i shërbimeve mediatike audiovizuale është i detyruar që para emetimit të tyre të sigurojë paralajmërim akustik paraprak dhe mundësi që të njihen me ndihmë të shenjave vizuale gjatë gjithë kohëzgjatjes së transmetimit të programeve së tyre.

(4) Operatorët e rrjeteve publike komunikuese elektronike mund të emetojnë ose riemetojnë servise programore me pornografi vetëm në formë të koduar.

(5) Është e ndaluar emetimi ose riemetimi i pornografisë fëmijërore

(6) Masat teknike, periudhat e emetimit, paralajmërimin akustik, shenjat vizuale dhe mënyrën e veprimit të ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale në rastet sipas paragrafëve (1) dhe (3) të këtij neni i përcakton Agjencia.“.

Neni 16

Pas nenit 50 shtohet titull i ri dhe nen i ri 50-a – si më poshtë:

“Neni 50-a

Mbrojtja e të dhënave personale të personave të mitur

Të dhënat personale të personave të mitur të mbledhur ose në mënyrë tjetër të gjeneruar ose të përfituara nga ofruesit e shërbimeve mediatike gjatë zbatimit të masave të nenit 50 të këtij Ligji nuk mund të përpunohen për qëllime komerciale, siç janë marketingu i drejtpërdrejtë, profilizimi dhe analiza ose reklamimi i sjelljes.”.

Neni 17

Në neni 53, paragrafët (7), (13) dhe (20) ndryshohen si më poshtë:

„(7) Nuk është e lejuar çfarëdo qoftë forme e komunikimit komercial audiovizual që promovon drogë, cigare ose produkte tjera të duhanit, cigare elektronike dhe mjete për mbushjen e tyre, si dhe alkool dhe pije alkoolike, përveç verës dhe birrës.

(13) Komunikimet komerciale audiovizuale nuk guxojnë t’u shkaktojnë dëm fizik, psikik ose moral personave të mitur.

(20) Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale miratojnë kodeks të mirësjelljes në përputhje me nenin 26–a të këtij ligji për reduktimin efektiv të ekspozimit të personave të mitur ndaj komunikimeve komerciale audiovizuale për pijet alkoolike në afat prej dy viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Nëse ofruesit e shërbimeve mediatike dhe audiovizuale nuk miratojnë kodeks të mirësjelljes dhe ai nuk rezulton mjaftueshëm efektiv brenda dy viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji ose nëse kodi i mirësjelljes nuk zbatohet efektivisht brenda dy viteve nga data e miratimit të tij, masat për reduktimin efektiv të ekspozimit të të miturve ndaj komunikimeve komerciale audiovizuale për pijet alkoolike përcaktohen nga Agjencia.”.

Pas paragrafit (20) shtohet paragraf i ri (21) si më poshtë:

“(21) Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale miratojnë kodeks të mirësjelljes në përputhje me nenin 26-a të këtij ligji si formë e vetërregullimit, në lidhje me komunikimet e papërshtatshme komerciale audiovizuale që i bashkëngjisin ose emetohen në kuadër të programeve të destinuara për fëmijë ose video të krijuara nga përdoruesit të destinuara për fëmijë, në të cilat paraqiten ushqime dhe pije që përmbajnë materie ushqyese dhe materie me efekt ushqyes ose efekt fiziologjik, veçanërisht yndyra, acide transydyrore, kripë, natrium dhe sheqerna, marrja e tepërt e të cilave nuk rekomandohet në ushqimin e fëmijëve, brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Nëse ofruesit e shërbimeve mediatike dhe audiovizuale nuk miratojnë kodeks të mirësjelljes dhe ai nuk rezulton mjaftueshëm efektiv brenda dy viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji ose nëse kodi i mirësjelljes nuk zbatohet në mënyrë efektive brenda dy viteve nga data e miratimit të tij, masat për reduktimin efektiv të ekspozimit të të miturve ndaj komunikimeve komerciale audiovizuale për ushqime dhe pije të larta në yndyrë, acide yndyrore trans, sheqerna, natrium dhe kripë janë të përcaktuara nga Agjencia. “.

Neni 18

Në nenin 54, paragrafi (6) ndryshohet si më poshtë:

„(6) Shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale ose programet nuk guxojnë të sponsorizohen nga persona juridikë ose fizikë veprimtaria kryesore e të cilëve është prodhimtaria ose shitja e cigareve dhe produkteve tjera të duhanit nga duhani ose cigare elektronike dhe mjete për mbushjen e tyre.“.

Neni 19

Neni 55 ndryshohet si më poshtë:

“(1) Vendosja e prodhimeve është i lejuar në të gjitha llojet e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale, me përjashtim të lajmeve dhe programeve kushtuar çështjeve dhe temave aktuale, programeve kushtuar çështjeve lidhur me konsumatorët, programeve fetare dhe programeve për fëmijë.

(2) Programet audio dhe audiovizuale që përmbajnë vendosjen e prodhimeve duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- përmbajtja dhe organizimi i tyre në kuadër të skemës programore, në rastin e emetimeve televizive dhe radiofonike, ose në katalogun e programeve, në rastin e shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, në asnjë rast nuk do të durojnë ndikim në mënyrë që do të ketë efekt mbi përgjegjësinë dhe pavarësinë editoriale të ofruesit të shërbimit mediatik;

- nuk do të inkurajojë drejtpërdrejt blerjen ose marrjen me qira të mallrave ose shërbimeve, veçanërisht përmes rekomandimi të veçantë promovues të mallrave dhe shërbimeve;

- nuk do t'i kushtojnë rëndësi të tepër (theksim ose dedikim) produktit për të cilin bëhet fjalë;

- shikuesit dhe dëgjuesit të jenë të informuar qartë për ekzistencën e vendosjes së produkteve në fillim dhe në fund të programit dhe gjatë rifillimit të programit pas çdo pauze për reklamë, me qëllim që të shmangët konfuzioni midis shikuesve dhe dëgjuesve.

(3) Dispozitat e paragrafit (2), nënparagrafi (4) të këtij neni nuk do të zbatohen nëse programi audio dhe audiovizual që përmban vendosje të produktit nuk është prodhuar ose porositur nga ofruesi i shërbimeve mediatike ose nga ndërmarrja e lidhur me ofruesin e shërbimeve mediatike.

(4) Nuk është i lejuar vendosja e cigareve dhe e produkteve të tjera të duhanit, cigareve elektronike dhe mjeteve për mbushjen e tyre, alkooli dhe pijeve alkoolike (përveç verës dhe birës) armë, mjete për qitje dhe mjete piroteknike si dhe vendosja e prodhimeve të personave fizikë ose juridikë veprimtaria kryesore e të cilëve është prodhimtaria ose shitja e shërbimeve për të cilat me këtë ligj janë të ndaluar komunikimet komerciale audio dhe audiovizuale.

(5) Nuk është i lejuar vendosja e prodhimeve mjekësore dhe trajtimeve mjekësore që lëshohen vetëm me recetë të mjekut.

(6) Dispozitat e këtij ligji me të cilat rregullohet vendosja e prodhimeve zbatohen për programe që do të prodhohen pas muajit janar të vitit 2014.”.

Neni 20

Në nenin 56, paragrafët (2), (3) dhe (8) fshihen.

Paragrafët (4), (5), (6), (7), dhe (9) bëhen paragrafët (2), (3), (4), (5) dhe (6).

Pas paragrafit (9) i cili bëhet paragrafi (6), shtohet paragrafi i ri (7), si më poshtë:

“Formën dhe përmbajtjen e formularit të aplikimit sipas paragrafit (1) të këtij neni për ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, si dhe për atë se cili person fizik konsiderohet ofrues i shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, i përcakton Agjencia.”.

Neni 21

Neni 60 ndryshohet si më poshtë:

“(1) Pjesa e veprave europiane në katalogët e programeve të ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës nën juridiksionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut duhet të jetë së paku 30% dhe veprat europiane duhet të pozicionohen në katalogun e programeve në mënyrë të tillë që të jenë të dukshme në mënyrën e duhur

(2) Detyrimi sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk do të zbatohet ndaj ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me qarkullim të vogël ose shikueshmëri të vogël, si dhe ndaj ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës kur është jopraktike ose e pajustificuar për shkak të natyrës ose temës së përmbajtjes mediatike audiovizuale që ato e ofrojnë.

(3) Me kërkesë të Agjencisë, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës janë të detyruar t'i paraqesin Agjencisë dokumentet e nevojshme për pjesën e veprave europiane në katalogun e programeve dhe shikueshmërinë e tyre. “

(4) Mënyra e sigurimit të pjesëmarrjes dhe shikueshmërisë së veprave europiane në katalogun e programeve sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe shmangiet sipas paragrafit 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e nevojshme sipas paragrafit 3 të këtij neni, i përcakton Agjencia.”.

Neni 22

Neni 61 fshihet.

Neni 23

Në nenin 99, paragrafët (1), (4) dhe (5) zëvendësohen si më poshtë:

“(1) Reklamimi dhe videoklipe teleleshingu sipas rregullës emetohen në blloqe të futura brenda dhe ndërmjet programeve. Me përjashtim videoklipe të izoluara reklamuese dhe teleleshingu janë të lejuara në transmetime të ngjarjeve sportive. Videoklipe të izoluara reklamuese dhe teleleshingu në programe të tjera dhe ndërmjet programeve transmetohen si përjashtim.

(4) Reklamimi nuk mund të emetohet në programe për fëmijë kohëzgjatja e të cilave është e njëjtë ose më e shkurtër se 30 minuta. Emetimi i teleleshingut në programe për fëmijë është i ndaluar.

(5) Në programet për fëmijë që zgjasin më shumë se 30 minuta (pa kohën e ndarë për reklamim) mund të emetohen videoklipe reklamuese një herë për çdo periudhë prej 30 minutash.”.

Neni 24

Neni 100 ndryshohet si më poshtë:

“(1) Kohëzgjatja e reklamave dhe videoklipeve të teleleshingut të emetuara në periudhën ndërmjet orës 6:00 dhe 18:00 nuk guxon të jetë më shumë se 20% të kohës së përgjithshme të emetimit në atë periudhë. Kohëzgjatja e reklamave dhe videoklipeve të teleleshingut të emetuara në periudhën ndërmjet orës 18:00 dhe 24:00 nuk guxon të jetë më shumë se 20% të kohës së përgjithshme të emetimit në atë periudhë.

(2) Dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni nuk zbatohen për shërbimin radiodifuziv publik. “

(3) Kohëzgjatja sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk zbatohet në:

- shpallje të radiodifuzerit lidhur me programet e tij personale dhe prodhimet ndihmëse të realizuara drejtpërdrejt nga ato programe, shpallje për sponsorizim dhe vendosjen e prodhimeve kuadro neutrale midis përmbajtjes së redaktuar dhe reklama dhe videoklipe teleleshingu, si dhe ndërmjet videoklipeve individuale, dhe

- kumtesa me interes publik dhe apele për qëllime vullnetare që radiodifuzerët i emitojnë falas dhe i shënojnë si “etime falas.”.

Neni 25

Pas nenit 100, shtohet nen i ri 100-a, si më poshtë:

“Neni 100-a

Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen, me respektimin e karakteristikave të tyre specifike, për shërbimet programore televizive të destinuara ekskluzivisht për emetimin e reklamave dhe teleleshingut, si dhe për shërbimet programore televizive të destinuara për vetëpromovim, me përjashtim të dispozitave të neneve 91, 99 dhe 100 të këtij Ligji.”.

Neni 26

Në nenin 105, paragrafët (1) dhe (2) ndryshohet si më poshtë:

“(1) Mjetet për financimin e veprimtarisë radiodifuzive, për funksionimin dhe zhvillimin e RTM-së Ndërmarrjes Publike Radiodifuzive të Maqedonisë dhe Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në shumën prej 1% nga të hyrat tatimore të realizuara, të përcaktuara në llogarinë përfundimtare të miratuar të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Mjetet e paragrafit (1) shpërndahen si më poshtë:

- 80% për RTM-së për të mbuluar shpenzimet për krijimin dhe transmetimin e programeve dhe për zhvillimin tekniko-teknologjik,

- 15% për NP Radiodifuzive e Maqedonisë për mirëmbajtjen, shfrytëzimin dhe zhvillimin e rrjetit publik transmetues dhe

- 5% për Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale. “

Në paragrafin (3), fjala “emetuar” zëvendësohet me fjalën “e realizuar”.

Në paragrafin (4), fjala “rregulluese” zëvendësohet me fjalën “redaktuese”.

Pas paragrafit (7) shtohet paragraf i ri (8), si më poshtë:

“(8) Mjete shtesë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut ndahen edhe për investime kapitale për zhvillimin e shërbimit të transmetimit publik, për rrjetin e transmetimit publik ose për kapacitetet tekniko-teknologjike të Agjencisë për zhvillimin e veprimtarisë, bazuar në një Studim fizibiliteti të miratuar me një konstruksion financiar të kostove të planifikuara dhe një arsyetim të bashkangjitur për shfajësimin e tij. Qeveria e miraton Studimin brenda tre muajve nga dita e dorëzimit të tij.”.

Paragrafët (8), (9) dhe (10), bëhen (9), (10) dhe (11).

Neni 27

Pas Kapitullit VIII shtohet Kapitull i ri VIII-a dhe tetë nene të reja 144-a, 144-b, 144-c, 144-ç, 144-d, 144-dh, 144-e dhe 144-ë, si më poshtë:

“VIII-a. PLATFORMA PËR SHPËRNDARJEN E VIDEOVE

Neni 144-a

Juridiksioni mbi platformat për shpërndarjen e videove

(1) Dispozitat e këtij Ligji që kanë të bëjnë me platformat e shpërndarjes së videove zbatohen për ofruesit e shërbimeve të platformave të shpërndarjes së videove:

- të cilat janë të themeluara në Republikën e Maqedonisë së Veriut,

- ndërmarrjeve amë të cilat janë themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut,

- ndërmarrjet filiale të cilat janë të themeluara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa ndërmarrjet amë të cilat nuk janë të themeluara në vendeve anëtare të Bashkimit Europian,

- të cilat i përkasin grupi ndërmarrjesh, nga ku ndërmarrje tjetër nga ai grup është e themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa ndërmarrjet amë dhe filiali nuk janë themeluar në vendeve anëtare të Bashkimit Europian,

- filiali i së cilës fillimisht filloi me kryerjen e aktivitetit të saj në Republikën e Maqedonisë së Veriut në përputhje me rregulloret e Republikës së Maqedonisë së Veriut, para se disa nga filialet e saj të fillojnë me kryerjen e aktivitet në vendeve anëtare të Bashkimit Europian, pjesë e konsiderueshme e veprimtarive ekonomike të saj, në mënyrë të vazhdueshme kryhen në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe mban marrëdhënie stabile dhe efektive lidhur me ekonominë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa ndërmarrja amë nuk është e themeluar në vendeve anëtare të Bashkimit Europian,

- të cilat janë pjesë e një grupi ndërmarrjesh ku ndërmarrje tjetër nga ai grup fillimisht ka filluar me kryerjen e veprimtarisë së saj në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në përputhje me rregulloret e Republikës së Maqedonisë së Veriut, para se disa ndërmarrje të tjera nga i njëjti

grup të fillojnë me kryerjen e veprimtarive të tyre në vendin anëtar të Bashkimit European; pjesë e konsiderueshme e veprimtarisë së tyre ekonomike i kryejnë aktualisht dhe në mënyrë të vazhdueshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe mbajnë marrëdhënie stabile dhe efektive me ekonominë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa ndërmarrja amë dhe filiali nuk janë të themeluara në shtetin anëtar të Bashkimit European.

(2) Për nevoja të paragrafit 1 të këtij neni:

-“Ndërmarrja amë” është ndërmarrje që ka kontroll mbi një ose më shumë ndërmarrje filiale,

-“ndërmarrje filial” është ndërmarrje që është nën kontrollin e ndërmarrjes amë, duke përfshirë ndërmarrjet filial të ndërmarrjes amë në krye,

- “Grupi” i përfshin ndërmarrjet amë, të gjitha ndërmarrjet e saj filiale dhe të gjitha ndërmarrjet e tjera që kanë lidhje organizative ekonomike dhe juridike me to.

(3) Për ofruesit e shërbimeve të platformës së shkëmbimit të videove, të cilat konsiderohen të jenë themeluar në vende anëtare të Bashkimit European, zbatohen në përputhje me rrethanat e dispozitave të Ligjit të Tregtisë Elektronike, me të cilën është rregulluar kufizimin e ofrimit të shërbimeve të shoqërisë së informatike.

(4) Agjencia themelon dhe mirëmban listën e përditësuar të ofruesve të shërbimeve të platformës për shpërndarje të videove, të cilët janë themeluar ose konsiderohen të themeluar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me dispozitat e nenit 144-b të këtij ligji dhe tregon se cili nga kriteret e paragrafit (1) të këtij neni bazohet juridiksioni i tij.

(5) Agjencia ia dorëzon Komisionit European listën, si dhe të gjitha versionet e përditësuara të saj.

Neni 144-b

Regjistri i shërbimeve të platformës së shpërndarjes së videove

(1) Ofruesit e shërbimeve të platformës së shpërndarjes së videove janë të detyruar të regjistrohen në Agjenci para se të fillojnë ta ushtrojnë veprimtarinë, me dorëzimin e aplikimit për evidentim në Regjistrin e ofruesve të Shërbimeve të Platformës së shpërndarjes së videove, i cili mbahet në Agjenci, për të cilin Agjencia u lëshon vërtetim për regjistrim.

(2) Me aplikimin e paragrafit (1) të këtij neni, paraqitet gjendja aktuale nga Regjistri Qendror dhe përshkrimi teknik me karakteristika të hollësishme teknike për mënyrën në të cilin ofrohet shërbimi.

(3) Nëse aplikimi nuk është i plotë, Agjencia me shkrim e njofton parashtruesin e aplikimit që ta plotësojë dhe ta dorëzojë në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimi të njoftimit.

(4) Agjencia nuk guxon ta refuzojë evidentimin e ofruesit të shërbimit të platformës së shpërndarjes së videove në Regjistrin e ofruesve të shërbimeve të platformës për shpërndarjen e videove, përkatësisht të lëshojë vërtetimin e paragrafit (1) të këtij neni, nëse aplikimi i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme.

(5) Agjencia është e detyruar që vërtetimin e paragrafit (1) të këtij neni ta lëshojë në afat prej pesë ditësh pune nga dita e pranimi të aplikimit, gjegjësisht nga dita e përfundimit të afatit shtesë sipas paragrafit (3) të këtij neni, nëse kërkesa i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme.

(6) Ofruesi i shërbimit të platformës për shpërndarjen e videove është i detyruar ta njoftojë Agjencinë për çdo ndryshim të të dhënave të specifikuar në aplikim në afat prej 30 ditëve nga dita e ndryshimit. Agjencia është e detyruar ta fusë ndryshimin e të dhënave në Regjistrin e paragrafit (1) të këtij neni, në afat prej tre ditëve pune nga dita e pranimi të njoftimit.

(7) Agjencia i publikon të dhënat nga Regjistri i paragrafit (1) të këtij neni në ueb faqen e saj, në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale.

(8) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës dhe të Regjistrin të paragrafit (1) të këtij neni, i përcakton Agjencia.

Neni 144-c

Mbrojtja e personave të miturve dhe ruajtja e ligjshmërisë së platformave për shpërndarjen e videove

(1) Ofruesit e shërbimeve platforma për shpërndarjen e videove nën juridiksionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të detyruar të ndërmarrin masat e duhura për mbrojtjen e:

- personave të mitur nga programet, videot e krijuara nga përdoruesit dhe nga komunikimet komerciale audiovizuale që mund të dëmtojnë zhvillimin e tyre fizik, mendor ose moral, në përputhje me nenet 50 dhe 53 të këtij ligji;

- publikut nga programe, video të krijuara nga përdoruesit dhe komunikimet komerciale audiovizuale që përhapin, justifikojnë, nxisin dhe/ose krijojnë rrezik të qartë dhe të drejtpërdrejtë të nxitjes së urrejtjes, dhunës ose diskriminimit ndaj individëve ose grupeve në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë nacionale ose etnike, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, përkatësisë në grup të marginalizuar, gjuhës, shtetësisë, përkatësisë sociale, religjioze ose besimit fetar, besimit politik, besimit tjetër, paafësia, mosha, statusi familjar ose martesor, gjendja pronësore, gjendja shëndetësore, karakteristika personale dhe statusi social ose ndonjë bazë tjetër.

- publikut nga programe, video të krijuara nga përdoruesit dhe komunikimeve audiovizuale komerciale, shpërndarja e të cilave paraqet aktivitet që është vepër penale sipas Kodit Penal, duke përfshirë nxitjen publike për kryerje të akteve terroriste, akte që lidhen me pornografinë e fëmijëve dhe vepra penale që lidhur me racizmin dhe ksenofobinë, sipas nenit 48 të këtij ligji.

Neni 144-ç

Masa për mbrojtjen e personave të mitur dhe publikut nga përmbajtja e dëmshme dhe e paligjshme në platformat për shpërndarjen e videove

(1) Ofruesit e shërbimeve të platformave për shpërndarjen e videove në kushtet e shfrytëzimit të shërbimeve të tyre përcaktojnë masa adekuate për mbrojtjen e personave të mitur nga programet, videot e krijuara nga përdoruesit dhe komunikimet komerciale audiovizuale që mund të dëmtojnë zhvillimin e tyre fizik, psiqik ose moral, në përputhje me nenet 50 dhe 53 të këtij Ligji.

(2) Nëse ofruesi i shërbimit të platformës për shpërndarjen e videove është në dijeni për ekzistencën e përmbajtjeve të theksuara në nenin 144-c të këtij Ligji, është i detyruar të heqë menjëherë programin, videon e krijuar nga përdoruesi ose komunikimi komercial audiovizual nga platforma për shpërndarjen e videove ose për të bllokuar aksesin në to.

(3) Paralajmërim se programi, video e krijuar nga përdorues ose komunikimi komercial audiovizual mund të dëmtojë zhvillimin fizik, psiqik ose moral të të miturve patjetër duhet të vendoset në fillim të çdo programi të tillë, video të krijuar nga përdoruesi ose komunikim komercial. Paralajmërimi patjetër duhet të vendoset në mënyrë të kuptueshme për shikuesit për t'i informuar ata se programi që vijon nuk është i përshtatshëm për personat e mitur, ndërsa shenjë e përshtatshme se programi nuk është i përshtatshëm për personat e mitur ose për një grupmoshë të caktuar të miturish duhet të shfaqet në ekran gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit, videos ose komunikimit komercial audiovizual.

(4) Ofruesit e shërbimeve platforma për shpërndarjen e videove në kushtet e përdorimit të shërbimeve të tyre përcaktojnë masat e duhura për parandalimin e përhapjes së përmbajtjeve të theksuara në nenin 48 të këtij Ligji, në përputhje me ndalimin e nenit 144-c të këtij Ligji.

(5) Masat nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni duhet të përfshijnë:

- themelimin dhe funksionimin e sistemeve për verifikimin e moshës për përdoruesit e platformave për shpërndarjen e videove në lidhje me përmbajtjen që mund të dëmtojë zhvillimin fizik, psikik ose moral të personave të mitur;

- themelimin dhe udhëheqjen me sisteme të thjeshta t'u përdorur, të cilat u mundësojnë përdoruesve të platformave për shpërndarjen e videove të vlerësojnë përmbajtjet e theksuara në nenin 144-c të këtij ligji;

- sistemet për kontroll prindëror mbi të cilat përdoruesi fundor ka kontroll për sa i përket përmbajtjes që mund të dëmtojë zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve;

- krijimin dhe funksionimin e mekanizmave transparente dhe të lehtë për t'u përdorur, që u mundësojnë përdoruesve të platformave për shpërndarjen e videove t'i shënojnë ose raportojnë te ofruesi përkatës i shërbimit platformë për shpërndarjen e videove përmbajtjet të cilat ofrohen në platformën e tij, dhe që theksohen në nenin 144-c të këtij ligji;

- themelimin dhe udhëheqjen me sisteme nëpërmjet të cilave ofruesit e shërbimeve të platformës për shpërndarjen e videove mund të njoftojnë përdoruesit e platformës së shpërndarjes së videove për veprimet e ndërmarra në lidhje me raportimin dhe shënjin sipas nënparagrafit 4 të këtij paragrafi;

- themelimin dhe udhëheqjen e procedurave transparente, të lehta për t'u përdorur dhe efektive për përpunimin dhe zgjidhjen e ankesave të përdoruesve të paraqitura te ofruesi i shërbimit të platformës së shpërndarjes së videove në lidhje me zbatimin e masave nga paragrafët 4 dhe 5 të këtij paragrafi;

- sigurimin e masave dhe mjeteve efektive të edukimit mediatik dhe për rritjen e ndërgjegjësimit të përdoruesve për këto masa dhe mjete.

(6) Të dhënat personale të personave të mitur të mbledhura ose të gjeneruara ose të fituara ndryshe nga ofruesit e shërbimeve të platformës së shpërndarjes së videove gjatë zbatimit të masave të këtij neni nuk mund të përpunohen për qëllime komerciale, të tilla si marketingu i drejtpërdrejtë, profilizimi dhe analiza ose reklamimi i sjelljes.

Neni 144-d

Komunikimi komercial i platformave për shpërndarjen e videove

(1) Ofruesi i shërbimit të platformës për shpërndarjen e videove nën juridiksionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut i përmbushin kërkesat e nenit 53 të këtij ligji në lidhje me komunikimet komerciale audiovizuale që plasohen, shiten ose redaktohen nga ofruesit e shërbimeve të platformës për shpërndarjen e videove.

(2) Ofruesi për shpërndarjen e videove nën juridiksionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ndërmarrin masa të harmonizohen me kërkesat e nenit 53 të këtij Ligji në lidhje me komunikimet komerciale audiovizuale të cilat nuk i plasojnë, shesin apo nuk i redaktojnë ato, duke pasur parasysh kontrollin e kufizuar që platformat e shpërndarjes së videove kanë mbi komunikime të tilla komerciale audiovizuale.

(3) Ofruesi i shërbimit të platformës së shpërndarjes së videove në kushtet për shfrytëzim të shërbimit përcakton se komunikimet komerciale audiovizuale të transmetuara në platformën e shpërndarjes së videove duhet të jenë në përputhje me nenet 53, 54 dhe 55 të këtij ligji, si dhe dispozitat e ligjeve dhe rregulloreve të tjera që kanë të bëjnë me reklamata.

(4) Ofruesi i shërbimit të platformës së shpërndarjes së videove duhet të sigurojë që ekziston aplikacion që do tu mundësojë përdoruesve që ngarkojnë video të krijuara nga përdoruesit të informojnë se videoja përmban komunikime komerciale audiovizuale për të cilat ata janë të vetëdijshëm dhe i dinë, ose në mënyrë të arsyeshme duhet të pritët të dinë se ekzistojnë.

(5) Ofruesi i shërbimit platformë për shpërndarjen e videos shprehimisht e informon përdoruesin nëse programet dhe videot e krijuara nga përdoruesit përmbajnë komunikime komerciale audiovizuale, me kusht që ofruesi të jetë në dijeni të ekzistencës së komunikimeve komerciale audiovizuale.

(6) Ofruesit e shërbimeve të platformës për shpërndarjen e videove nën juridiksionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratojnë kodeks sjelljeje për:

- reduktimin efektiv të ekspozimit të fëmijëve ndaj komunikimeve komerciale audiovizuale për ushqimin me përmbajtje të lartë të yndyrave, acideve trans yndyrore, sheqernave, natriumit dhe kripës në programet dhe videot e krijuara nga përdoruesit e destinuar për fëmijë, në përputhje me nenin 53, paragrafi (21) të këtij ligji.

- për reduktimin efektiv të ekspozimit të fëmijëve ndaj komunikimeve komerciale audiovizuale për pije alkoolike, në përputhje me nenin 53 paragrafi (20) të këtij Ligji.

(7) Nëse ofruesit e shërbimeve të platformave për shpërndarjen e videove nuk i miratojnë kodekset e paragrafit (6) të këtij neni në afat brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nëse kodet e mirësjelljes nuk zbatohen në mënyrë efektive në afat brenda dy viteve nga miratimi i tyre, kërkesat çështjet të cilave u referohen këto kodekse i përcakton Agjencia.

Neni 144-dh

Zbatimi i masave nga ana e platformave për shpërndarjen e videove

(1) Ofruesit e shërbimeve platforma për shpërndarjen e videove për zbatimin e dispozitave të këtij ligji përcaktojnë masat e duhura, duke marrë parasysh natyrën e përmbajtjes së cilës i referohen, dhe mund të shkaktojë ajo përmbajtje, veçoritë e kategorisë së personave që do të mbrohen, si dhe të drejtat dhe interesat legjitime të cilave u referohen masat, duke përfshirë interesat e ofruesve të shërbimeve të platformave të shpërndarjes së videove, interesat e përdoruesve që krijuan dhe ngarkuan përmbajtjen, si dhe interesin publik. Masat duhet të jenë të zbatueshme dhe proporcionale, duke marrë parasysh madhësinë e platformës së shpërndarjes së videos dhe natyrën e shërbimit që ajo ofron, dhe nuk do të shpie në masa paraprake për kontroll ose filtrim kur ngarkoni përmbajtje që nuk janë në përputhje me dispozitat e ligjeve dhe rregulloreve me të cilat rregullohen sferat e transaksioneve komerciale dhe elektronike legale. Masat më të rrepta duhet të zbatohen për të siguruar që personat e mitur të mbrohen nga përmbajtjet më të dëmshme, siç janë dhuna e tepruar dhe pornografia.

(2) Agjencia kryen vlerësim të masave të ndërmarra nga ofruesit e shërbimeve të platformave për shpërndarjen e videove nën juridiksionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe mbikëqyr zbatimin e të njëjtave.

(3) Ofruesit e shërbimeve platformë për shpërndarjen e videove inkurajohen të angazhohen në aktivitete bashkë- rregulluese, në përputhje me nenin 26-a të këtij ligji, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas këtij ligji.

(4) Mosmarrëveshjet ndërmjet përdoruesve dhe ofruesve të shërbimeve të platformave të shpërndarjes së videove që kanë të bëjnë me plotësimin e kushteve të këtij ligji mund të zgjidhen edhe jashtë gjykatës.

Neni 144-e

Kompensim për ofrimin e shërbimit të platformës për shpërndarjen e videove

(1) Ofruesit e shërbimeve të platformës për shpërndarjen e videove paguajnë kompensim vjetore për mbikëqyrje në llogari të Agjencisë.

(2) Kompensimi vjetor sipas paragrafit (1) të këtij neni arrin 0,5% të të ardhurave totale vjetore të ofruesit të shërbimit të platformës për shpërndarjen e videove, e realizuar me ofrimin e shërbimit gjatë vitit të kaluar kalendarik, ose në pjesë më të shkurtër të vitit që kur ofruesi i shërbimit të platformës së shpërndarjes së videove filloi të ofrojë shërbimin.

(3) Ofruesi i shërbimit të platformës për shpërndarjen e videove është i detyruar që më së voni deri në 15 mars të vitit aktual pranë Agjencisë të dorëzojë raportin për shumën e të hyrave të përgjithshme të paragrafit (2) të këtij neni.

(4) Ofruesi i shërbimit të platformës së shpërndarjes së videove është i detyruar që më së voni deri 15 prill të vitit aktual në llogari të Agjencisë të paguajë kompensimin vjetor për mbykëqyrje në bazë të raportit të mëhershëm të dorëzuar për shumën e të hyrave të përgjithshme të paragrafit (2) të këtij neni dhe pas një aktvendimi dhe faturë të dorëzuar paraprakisht nga ana e Agjencisë.

(5) Nëse Agjencia ka dyshime të bazuara për vërtetësinë e të ardhurave totale vjetore të arritura, ka të drejtë, në llogari të ofruesit të shërbimit të platformës së shpërndarjes së videove, të kryejë vlerësimin nga një auditor i jashtëm i pavarur.

(6) Nëse të ardhurat totale të vlerësuara devijojnë nga të ardhurat totale të raportuara, gjatë kompensimit vjetor sipas paragrafit (2) të këtij neni, Agjencia e detyron ofruesin e shërbimit të platformës së shpërndarjes së videove që të paguajë diferencën e llogaritur.

(7) Nëse ofruesi i shërbimit të platformës së shpërndarjes së videove nuk e paguan kompensimin vjetor të mbikëqyrjes, Këshilli do ta fshijë atë nga Regjistri i ofruesve të shërbimeve të platformës së shpërndarjes së videove.

Neni 144-ë

Dorëzimi i të dhënave në Agjenci

(1) Me kërkesë të Agjencisë, ofruesi i shërbimit të platformës së shpërndarjes së videove nën juridiksionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është i detyruar të dorëzojë të dhëna lidhur me përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ky ligj.

(2) Të dhënat e paragrafit (1) të këtij neni duhet të dorëzohen në afat prej tri ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës.”

Neni 28

Në nenin 147, në paragrafin (1), pas pikës 19 shtohen dy pika të reja 20. dhe 21., si më poshtë:

“20. Nuk i respekton detyrimet e nenit 26, paragrafët (1), (2), (3), (5) të këtij ligji.

21. Nuk i respekton detyrimet e nenit 49a, paragrafi (1) të këtij ligji.”

Në paragrafin (2), fjalët “dhe tregtar individual” fshihen.

Në paragrafin (3), shuma “500 euro” zëvendësohet me shumë “250 euro”.

Paragrafi (4) ndryshohet si më poshtë

“(4) Gjobë në shumë prej 250 euro, në kundërvlerë denari, do t’i shqiptohet edhe tregtarit individual për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni.”

Neni 29

Në nenin 148, paragrafi (1), fjalia hyrëse ndryshohet si më poshtë:

“(1) Gjobë në shumë prej 2.500 deri në 3.000 euro, në kundërvlerë denari, do t’i shqiptohet personit juridik për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni.” Pas pikës 28) shtohen gjashtë pika të reja 29), 30), 31), 32), 33) dhe 34), si më poshtë:

“29) ofron shërbimin e platformës për shpërndarjen e videove pa regjistrim paraprak të parashikuar në përputhje me nenin 144-b të këtij ligji,

30) nuk ndërmerr masat e duhura në përputhje me nenet 144-c dhe 144-ç të këtij ligji;

31) nuk ndërmerr masat e duhura të përcaktuara në nenin 144-e të këtij ligji;;

32) nuk ka dorëzuar në Agjenci raport për shumën e të hyrave të përgjithshme deri më 15 mars të vitit aktual në përputhje me (nenin 144-e, paragrafi (3) të këtij ligji),

33) nuk e ka paguar kompensimin vjetore për monitorimin e llogarisë së Agjencisë deri më 15 prill të vitit aktual siç është përcaktuar në nenin 144-e, paragrafi (4) të këtij ligji.

34) nuk i ka dorëzuar Agjencisë të dhënat që i ka kërkuar siç është përcaktuar në nenin 144-ë të këtij ligji”.

Në paragrafin (2), pas fjalës “personi juridik” vihet presje dhe shtohen fjalët “personi fizik”.

Paragrafi (3) fshihet.

Neni 30

Neni 149 paragrafi (1) fjalja hyrëse ndryshohet si më poshtë:

“(1) Gjorbë në shumë prej 1.500 deri në 2.000 euro, në kundërvlerë denari, do t'i shqiptohet personit juridik për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Në paragrafin (2) fjalët "tregtar individual" fshihen.

Pas paragrafit (2) shtohet paragrafi i ri (3) si më poshtë:

“(3) Gjorbë në shumë prej 250 euro, në kundërvlerë denari, do t'i shqiptohet edhe tregtarit individual për kryerje të kundërvajtjes sipas paragrafit (1) të këtij neni.”.

Neni 31

Në nenin 150, në paragrafin (1), fjalët “deri në tre vjet” zëvendësohen me fjalët “deri në dy vjet”.

Neni 32

Aktet nënligjore, miratimi i të cilave është i përcaktuar me këtë ligj, do të miratohen brenda dy vitesh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 33

Licenca për emetim televiziv ose radio të shoqërive radiodifuzive tregtare dhe të institucioneve të transmetimit jofitimprurës, të cilave u përfundon vlefshmëria nëntë vjeçare deri më 31 dhjetor 2024, zgjaten edhe për një periudhë prej tre vjetësh të tjerë nga dita e përfundimit të licencës.

Neni 34

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pushon së vlefshmi neni 151 i Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 42/20 dhe 77/21).

Neni 35

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pushon së vlefshmi dispozita e mëparshme e nenit 45 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 248/18).

Neni 36

Në të gjithë tekstin e ligjit, fjalët "Republika e Maqedonisë" zëvendësohen me "Republika e Maqedonisë së Veriut".

Neni 37

Autorizohet Komisioni Juridiko-Ligjvënës i Kuvendit të Republika e Maqedonisë së Veriut ta përcaktojë tekstin e konsoliduar të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Neni 38

Ky ligj hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.